

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E PESTË

V

Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së

Oslo, 2010

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut - Krijuesit të gjithësisë.

Përhëndetjet dhe selamet çofshin për të Dërguarin tonë besnik, familjen e tij dhe ata që pasojnë rrugën e tij deri në ditën e Kijametit.

Na ka arritur një letër e mrekullueshme nga një vajzë e re muslimane, në vitet më të reja të rinisë dhe të fesë (ka qenë letra e pesta me radhë). Nuk kishim mundësi t'i përgjigjemi, pasi që nuk kanë qenë kushtet e përshtatshme për ta përshkruar dhe komentuar përbërjen e letrës së saj.

Me zemër të sinqertë dhe me fjalët më të përzemërta e përhëndes, për fetvatë e saj dhe prej asaj çka ka përfituar shumë dhe ka pasur dobi të madhe prej fetave, sipas shkresës së saj.

E falënderoj atë dhe i jam shumë mirënjohës, në vend të të nderuarit të imamit të mirënjohur, pasi që shkresën e saj ia kam lexuar Imamit . Përhëndetje për të rënë muslimane S.M.M. Studente e Fakulteti Sociologjik.

Na ka arritur një shkresë nga lexuesi musliman SHAM nga Misr Xhedidetu, në të cilën thotë: Pasi që harresa e njeriut e nënçmon atë, ndikon për të bërë mëkat, e cila është vepër e shejtanit dhe për të cilën epet përgjegjësi. E pasi që drejtësia qiellore është e pakrahasueshme që të dënojë krijesën e Tij me një krijesë tjetër. Dhe pasi që njeriu është i krijuar, e xhinët janë krijesa tjera, duhet që njeriu të jep llogari vetëm për mëkatet që vetë i bën, e jo për mëkatet për të cilat shkaktar është shejtani. Cila është zgjidhja dhe çka është më së miri të veprohet në këtë rast?

Prej asaj çka kam kuptuar nga Shejh Shaëraviju dhe prej mësimave dhe bisedave që i kam zhvilluar vazhdimisht me të, dhe prej diturisë, ideve që i kam përfituar prej tij, pasi po e filloj me Bismilahirrahmanirrahim, dhe pasi që po përhëndes Pejgamberin fisnik, po përgjigjem:

Njeriu është i urdhëruar për adhurim të sinqertë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, ai po ashtu është i urdhëruar që t'iu largohet shejtanit të mos e dëgjojë atë. E nëse ai nënshtrohet urdhrave të shejtanit, ai veç ka kundërshtuar tekstin dhe urdhrin Kur'anor për të mos e dëgjuar shejtanin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"(Ju porosita) Të më adhuron Mua, se kjo është rruga e sigurt!
Vërtet, ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend?"

(*Jasinë, 61- 62*)

Njeriun, të cilin e hamend, e mashtron dhe e përvetëson shejtani, dhe i cili i nënshtrohet urdhrave të tij, ai është bërë prej ushtrisë së tij, dhe në çfarë mase njeriu i largohet kurtheve dhe mashtrimeve të shejtanit, po në atë masë imani i tij është i fortë.

O ju muslimanë, Allahu ju ka dhënë juve atë çka e doni prej të mirave të islamit. Dëgjojeni atë çka ju pastron, ju dëlirë dhe ju shndritë në adhurimin e Tij, për t'iu siguruar lumturi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, dhe derisa para jush të hapen dyert e faljes, zgjerimit, lehtësimit, ëmbëlsirës, mëshirës dhe kënaqësisë. Vërtet Allahu është Dëgjues dhe Pranues i lutjeve.

Shpirtrat *fisniko-qortues* gjithmonë pyesin dhe kërkojnë sqarime: A është kjo haram, a është kjo hallall? E kjo na gëzon se në thellësi të zemrave ka ndjenja të flakta për të hulumtuar çdo gjë çka e kënaqë Allahun, dhe për t'iu larguar prej çdo gjëje që e urren Allahu.

Ne çdo shekull, në çdo popull, në çdo kohë, dhe prej kohërave më të lashta ka ekzistuar hallalli dhe harami, mirëpo ka pasur dallime në mes të shkaktarëve dhe llojeve dhe në përcaktimin.

Çështja e hallallit dhe haramit ka ekzistuar edhe në tregime, fabula e përralla, të cilat e kanë humbur peshën dhe vlerën në vet substancën e tyre.

Hallalli ka ekzistuar te çdo fe dhe në çdo sekt, e deri në kohën e sodit, ku ka arritur niveli i lartë i zhvillimit, ku e ka edhe vendin e vet. Për këtë arsye edhe thirrja në njëshmërinë e Krijuesit dhe adhurimi ndaj Allahut me të cilat është obliguar i Dërguari a.s., janë prej ligjeve të cilat kanë qenë në kohë të caktuar dhe kanë përfunduar në kohën e caktuar.

Dhe kur ka ardhur Islami, i cili ka rolin për t'i sjellë njerëzimit pare e lumturi, deri në fund të ekzistimit të kësaj bote, ka qenë dashtë që të përfshijë çështjen e hallallit dhe haramit në tërësi, pra çdo gjë çka i nevojitet njeriut për lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër. Kjo formë e hallallit dhe e haramit do të vazhdojë edhe në të ardhmen pa ndërprerje, sa të ekzistojë jeta në të gjitha mënyrat e saj.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe (kam ardhë) që t'ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhë me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua”.

(Ali Imran, 50)

Po ashtu thotë:

“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: "Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona”.

“Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit”.

(El-Ea'rafë, 156-157)

Po ashtu thotë:

“Thuaj: Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robtë e vet? Thuaj: Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton”.

(El-Ea'rafë, 32)

Një lexues tjetër pyet: Unë kam mendime të këqija, nuk mund të tërhiqet prej tyre, dhe me mendimet e këqija edhe iu bëj keq njerëzve. Dhe pyet: Si të veprojmë me këto mendime dhe veprime të këqija?

I themi atij: Ai nuk na ka shkruar në letër se a falet apo jo, natyrisht ne presim prej tij përgjigje negative, sepse namazi të largon nga punët e këqija dhe imoraliteti. Por edhe nëse falet, është e mundur se namazi i tij është i papranuar, prandaj le të hulumtojë dhe le të shikojë rreth vetes së tij dhe atëherë kemi shpresë se Allahu do ta udhëzojë në rrugë të drejtë dhe të na largojë edhe neve edhe atë nga botëkuptimet e shejtanëve.

E ndiejmë për obligim me përmend se mendimet e këqija dhe armiqtësore, në psikologji kanë emërtim të veçantë të sëmundjes së tillë. Dhe nuk ka kurrfarë të keqe për ta drejtuar te psikologu, për shërim të kësaj sëmundjeje psikike. Pasi kam lexuar shumë

libra psikologjike nuk kam gjetur mjekim më të mirë dhe më të suksesshëm se leximi i Kur'anit të sëmureve psikik. Këtë e thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe Ne kemi zbritur nga Kur’ani çka është shërim dhe mëshirë për besimtarët”.

Sadakallahul Adhim

Zoti i Lartmadhëruar ka kërkuar lehtësim dhe falje për mëkatarin, keqbërësin ku thotë: Dhe dënimi i të keqes me të keqe të të njëjtës masë, por kush falë, dhe përmirëson, shpërblimin e ka te Allahu”.

Hakmarrja është drejtësi, teprimi në dënim është kalim i normave. Ai i cili tejkalon normën, ai ka bërë padrejtësi. Tepruesi ka tejkaluar kufirin e urtësisë dhe të mirës, e cila e ka barazuar dhe ka harmonizuar çdo çështje të jetës. Dhe mos harroni vlerat dhe dallimet mes jush”.

Dhe kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Dhe mos anoni me anim të tërësishëm”. Na ka dhënë bazën e logjikës dhe planprogramin madhështor. Zoti i Lartmadhëruar di se çka fshehin zemrat me diturinë e Tij të përhershme pa fillim, bazat e paralelizmit dhe barazimit dhe sjelljet e njeriut për këtë arsye nuk ka thënë vetëm “Mos anoni”, por ka thënë mos anoni me anim të tërësishëm, sepse animi i pjesshëm mundet të arsyetohet në disa çështje. Kjo është po në jetën normale, mirëpo e keqja e të keqes është animi në ekstremitet. Sepse çdo ekstremitet dhe çdo kryeneçësi e humb tërë vlerën dhe qëllimin e jetës.

O Zot na forco hapat në rrugën tonë që të kemi mundësi për t’iu përgjigjur letrave të lexuesve në përputhshmëri me lejen e Allahut. Jepi atyre dhe neve durim, sepse shumica e tyre presin me padurim. Mirëpo ne dëshirojmë që ata të na kuptojnë se jemi shumë, shumë afër tyre dhe së shpejti secili prej tyre do të marrë përgjigjen e pritur, me lejen e Allahut.

Kush dëshiron shpejtimin e një çështje dënohet me vonimin e saj. Por ne me tërë fuqinë tonë do të mundohemi që ata të mos presin shumë. E nesërmja është e afërt për pritësit. Zoti çoftë i kënaqur.

Kajro, 14 Safer, viti 1402 h.
10 Shtator, viti 1982 Isa a.s.

PËRZIERJA E DJEMVE ME VAJZA

Jeta e fakultetit, po a e di çka është jeta e fakultetit, e studentit. Në të janë të tubuar të gjitha të gjitha të mirat dhe të këqijat. Dituria i përfshinë të gjitha të mirat dhe të gjitha vlerat, ndërsa e gjithë e keqja, arroganca dhe kryeneçësia janë tubuar mbi (kundër) të mirës dhe vlerave. Posa të arrij djali apo vajza në shkallët e Universitetit ai apo ajo ekspozohen me rrobat e pubertetit dhe posa të takohen pozitivit dhe negativit e tërheqin njëra-tjetrën, dhe paraqiten në teatrin e adoleshencës nën hijen e “civilizimit” i ashtuquajtur bashkëkohësi dhe modernizim, ndërsa në esencë është në kundërshtim me planprogramin e Allahut.

Nuk do të kishim asnjë breng e kurrfarë rike. Vërtet në të gjitha vendet ngatërrohet kjo me atë e pastaj shohim përfundime të këqija dhe rezultate të padëshirueshme.

Shejh Shaëraviju në lidhje me përzierjen e djemve dhe vajzave thotë:

Përzierja e djemve dhe vajzave është një çështje jo natyrore dhe e palogjikshme. Unë këtë çështje e kam elaboruar, kur kam folur rreth tregimit të Musa a.s. me Shuajbin. Kam thënë se femra në ndonjë punë jashtë rrethit familjarë, del vetëm atëherë kur është ndonjë domosdoshmëri absolute.

Kam thënë, dëgjoni fjalët e Allahut të Lartmadhëruar:

“ ajeti ”

Fjala “Baba jonë i moshuar” dëshmon domosdoshmërinë, e cila i ka detyrua me dalë nga puna e nga shtëpia, duhet të jetë e përkufizuar “Nuk mund t’i bagëtisë me pi ujë përderisa të shkojnë barinj të tjerë.”

Nuk ka qenë domosdoshmëria e cila i ka detyruar me dalë në punë dhe me qenë në largësi prej shoqërimit me meshkuj, dhe “Baba jonë tepër i moshuar”, por pastaj tregon rolin e shoqërisë (së meshkujve) dhe iu ndihmoi atyre për me pi ujë bagëtia tyre.

Kjo do të thotë se kur një mashkull e sheh një grua se ka dalë për të siguruar ekzistencën dhe se domosdoshmëria e ka detyrua, nevojitet asaj me i ndihmuar, që ajo të shkojë drejt rrugës së saj dhe vajza apo gruaja e cila për shkak të domosdoshmërisë del dhe punon, asaj i ndihmohet për ta kryer atë nevojë.

Bija e Shuajbit i ka thënë babës së saj:

“O babai im shpërbleje atë, se vërtet atë cilin do ta shpërblesh është i fuqishëm dhe besnik.”

El Kasas 26

Ajo ka dëshiruar me zgjedh problemin e jetës së saj me atë ndodhi. Ne nuk e pengojmë femrën me punua, mirëpo ajo del me punua në hapësirën e saj familjare, ndërsa nëse del jashtë hapësirës së familjes së saj, ajo duhet të jetë e kujdesshme, e ndërgjegjshme dhe e matur. Pse domosdoshmëria nuk duhet a shtyjë atë që të përziehet me meshkuj dhe të veprojë çka të dëshirojë me ata.

Të marrim si shembull nëse femra ndien ndonjë nevojë të domosdoshme dhe del me punua në një mes, ku nuk ka burrëri edhe pse të gjithë ata janë burra, dhe ajo punon për ekzistencë, çka ka lidhje domosdoshmëria që ajo të del e zbuluar e parfumuar dhe me rroba tërheqëse.

Çka ka lidhje domosdoshmëria me zbulimin e trupit të saj?

Femra e cila del për studim, ndërsa ne themi se domosdoshmëria e ka shtyrë që ajo të përzihet me meshkuj.

Cila është ajo domosdoshmëri që ajo të vishet me rroba tërheqëse dhe me rroba të cilat nuk e mbulojnë në tërësi trupin e saj, që ajo të ndjek modën më të re.

Unë edhe në herët kam thënë: A thua dituria patjetër përftohet vetëm nëpërmjet gjoksit të të zbuluar!?

Vajza e cila del e zbuluar jashtë oborrit të shtëpisë së saj dhe ekspozon veten e saj para mashkullit, sepse zbulimi sa më i madh i femrës jashtë shtëpisë së saj do të thoshte pa fjalë: “Shiko, unë jam këtu. Eja.”

Mashkulli nuk ka mundësi me i ngrit ndjenjat e epshit, tani ai ka nevojë me i ftohë ndjenjat e epshit.

O popull! Bëni dallim në mes të angazhimit për jetë dhe mashtrimin të kësaj jete.

E DREJTA E TË ÇMENDURIT

Shejh Shaëraviju thotë: Njeriun të cilin e ka krijuar Allahu të çmendur, ndërsa ne e dimë se njeriu është i dalluar dhe i nderuar me mendje, a do të thotë kjo mos dhurimi i mendjes (çmendurie) veshja e atij njeriu prej gradës së nderit dhe fisnikërisë.

Pyes ? Çka dëshirojnë të mençurit dhe të fuqishmit me trupin e tyre ?

Çka dëshirojnë ata në këtë botë ?

Dëshirojnë vetëm me fol, e fjala e tyre me u dëgjuar e mos me iu refuzuar, dëshirojnë të veprojnë çka të dëshirojnë e askush mos me iu fol atyre.

Iu kam thënë atyre: I çmenduri është i tillë që kur të bie ty, ti qesh me të, ti nuk e kritikon me fjalë tjera nuk e pyet atë pse më mëshove, po ashtu edhe Allahu nuk e pyet atë ditën e kijametit “ Dhe bjere një njeri i cili nuk është i çmendur, ai tërë jetën angazhohet për me arrit qëllimin të cilin veç e ka arritur i çmenduri. Kështu na habitë fakti se deri sa për veprimtarinë e tij në këtë botë e quajnë të çmendur, atë në një moment prej momenteve të jetës së tij Allahu i jep fuqi sa fuqia e mendjes tënde dhe sa është jeta jote.

Po si realizohet kjo ?

Njeriu çështjet i kupton nëpërmjet mendjes së tij, të cilat pastaj i fshehë në vete e nuk i flet, ndërsa i çmenduri e flet të vërtetën dhe nuk mërzhitet, e thotë atë që ti nuk mundesh me thënë o i mençur ta thuash, e as nuk mundesh ti ikësh asaj.

Kjo është që na shpie te kuptimi “mendje-akl, ndërlidhje”. Pse quhet mendje? Sepse aq shumë është i ndërlidhur me ty saqë as që mund t’i ikësh.

Ndërsa i çmenduri as që mërzhitet. Pra i çmenduri në një moment prej momenteve të çmendurisë së tij. Shpaguhet me atë që ti nuk mund ta arrish tërë jetën me mendjen tënde, “Qoftë i lartësuar Zoti i Lartmadhëruar”.

SHFUQIZIMI I LIGJIT PARA OBLIGUESHMËRISË

Të gjithë e dimë se namazi është ligjësua drejtpërdrejtë në mes te Zotit të Lartmadhëruar dhe krijesës së tij dhe me të nderuarit të të Dërguarve të tij dhe valës së pejgamberëve , zotërisë tonë Muhamedit a.s. . Ashtu siç na është transmetuar Pejgamberi s.a.v.s. prej Zotit është obligua me i falë 50 kohë të namazit në ditë. E dimë edhe atë se Musa a.s. e ka këshillua dhe Muhamedi a.s. është kthye te Zoti i Lartmadhëruar sa që namazi ka zbrit prej 50 kohëve në ditë në 5 kohë, mirëpo shpërblimi është si me i falë 50 kohë. Disa kanë thënë se këto janë israilijatë, pse tregojnë porosinë e popullit të Musa a.s. Umetit të Muhamedit s.a.v.s.

Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë transmetim thotë: Musa është i Dërguari i Allahut. Ai është prej pejgamberëve të dalluar (Ulul Azm). Dhe mënyra se si ka kërkuar prej Muhamedit a.s. që ai me kërkuar që me iu zbrit. Ne nuk shohim se është porosi? Çka është porosia ?

Porosi është kur kërkohet prej njeriut të cilit iu është obligua diçka, me u obligua më shumë. Ndërsa porosia e cila kërkon lehtësinë a quhet porosi?

Musa a.s. ka dëshirua me u lehtësua një çështje sepse ai e ka ditë se nuk mundet me u krye.

Transmetimi “Vërtet populli yt nuk mundet”,sikurse ka dëshirua me ua lehtësua çështjen Umetit Islam.

E tashti ne e analizojmë dhe e diskutojmë atë çështje, posaçërisht pasi që kemi transmetim tjetër ku thuhet “Vërtet Umeti yt është i dobët, dhe nuk mundet, ka edhe transmetime të ngjashme.

Kjo është ajo çka thuhet: Mirëpo kur Musa a.s. kur thotë: “Unë i kam sprovuar popujt para teje”, dihet se Allahu nuk ia ka bërë obligim popullit të Musa a.s. më shumë se dy namaze: Namazin e mesnatës dhe namazin e mesditës, mirëpo edhe këto dy namaze nuk i kanë kryer. E, Musa a.s. kur e ka pa se populli i tij nuk ka mundur me i falë dy namaze, i ka thënë Muhamedit a.s. atë që i ka thënë: Ky është argument se ai e ka dashur të Dërguarin e Allahut, dhe Umetin e të Dërguarit të Allahut, e për këtë arsye nuk ka dashur që ata të obligohen ashtu siç është obliguar Umeti i tij, e pastaj ata nuk do të kishin mundur me i krye.

Pra kjo nuk është dëshmi se ne jemi të dobët, por është supozim se ne nuk forcohemi me këtë. Pse? Sepse eksperiencia e popujve të tjerë nuk e ka dëshmuar këtë dhe ka qenë i bindur se edhe Umeti i tij nuk mund të dëshiroj këtë. Pra kjo është çështje e cila dëshmon kundër tyre e jo kundër neve (kundër popullit të Musa a.s.)

Parashtrohet pyetja:

Pasi që Allahu ka dëshirua 50 namaze në fillim, pastaj i ka bë obligim pesë kohë, pse kështu?

I nderuari Imam Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Obligimet edhe pse vijnë prej Allahut, Allahu i Lartmadhëruar nuk ka nevojë për kryerjen e obligimeve tona, por obligimet janë për të mirën tonë. Parësore është se me kryerjen e obligimeve nuk ka dobi Allahu, por kemi dobi vetë ne.

Dhe përderisa Allahu i ka bë 5 kohë obligim me 50 shpërblime, atëherë dhurata është prej Allahut, e lehtësimit ka ardhur nëpërmjet shkakut dhe arsyes, e Allahu nuk e ka pran pakësimin e pagesës dhe shpërblimit.

Pyetja është:

Si me shfuqizua Allahu një ligj para se të vendoset?

Imami i mirënjohur thotë:

Njerëzit e kuptojnë se qëllimi i obligimit prej Allahut është kryerja e obligimit që do të thotë çdo obligim prej Allahut përbëhet prej dy pjesëve.

Pjesa e parë: Besimi në çështjen e obliguar dhe pranimi i atij obligimi.

Pjesa e dytë: Kryerja e atij obligimi.

Nëse të parën e ke pranua, kjo do të thotë pjesën e parë e ke krye e pastaj vjen pjesa e dytë, veprimi pra kryerja e atij veprimi. Këtë pikë për ta sqaruar themi: p.sh. Iblisi e ka mëkatua ndaj Zotit të tij, po ashtu edhe Ademi ka mëkatua ndaj Zotit të tij, atëherë pse me u dëbua nga mëshira e Allahut, e pse Iblisi është pendua ndërsa Allahu ia ka pranua. Kjo sepse Iblisi ia ka kthye urdhrin, pra nuk e ka pranuar urdhrin, ndërsa kjo nuk ka ndodh me Ademin a.s. , pra Ademi e ka pranua urdhrin.

QETËSIMI I SHPIRTIT NË MARTESË DHE PREJ TIJ KA BË BASHKËSHORTEN E TIJ

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Dhe prej atij shpirti ka bë bashkëshorten e saj, e pse nuk ka thënë: dhe prej atij shpirti ka krijua bashkëshorten e saj.

Përgjigje:

Bashkautorët e librit “Mrekullia mjekësore në Kur’an” në të cilën Shejh Shaëraviju ka sqarua dallimin në mes të “bërjes dhe krijimit”.

Në lidhje me këtë Shejh Shaëraviju thotë: Fjala “ e ka bë” gjuhësisht kur të përdoret për një çështje, ka të bëjë me atë se nuk ka ekzistua dhe është krijua. Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe ka bë prej tij bashkëshorten e tij. “Këtu fjalë ka bë” ka kuptimin ka krijua.

Ndërsa kur të përdoret fjala “*ka bë*” për çështjen që veç ka ekzistua, kjo do të thotë është shndërrua në diçka tjetër, atëherë un i kuptoj dy çështje: e bërë dhe e bërë prej tij. E kam bë baltën Ibrik, e kam bë dërrasën tavolinë. Pra këtu ka dallim në mes të fjalës e cila është transitive në një folje, e kjo do të thotë krijimi prej asgjëje, ndërsa “*ka bë*” fjala e cila kalon në dy folje, sendi veç ka ekzistua por pastaj është shndërrua në diçka tjetër.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtetë unë të bëj ty udhëheqës (imam) për njerëzimin. Ti (o Ibrahim) veç je mirëpo me të bë imam është çështje tjetër.”

EL-MEDHIJ

“Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për *medhinë*?

Është përgjigj: Për atë shkak merret abdes.

Njëri thotë: Po nëse më bie stërpika në rroba prej saj?

Mjafton me morë ujë me grusht e ne hedh në vendin e stërpikur dhe e shikon a e ka përfshi ë tërën apo jo.”

FAZA E OBLIGUESHMËRISË

Cila është faza e obligueshmërisë, pra prej kur kërkohet nga njeriu me pasuar rrugën e Allahut dhe me i kryer obligimet?

Shejh Shaëraviju thotë:

Faza e obligueshmërisë është pjekuria, po çka është pjekuria: arritja e fazës së burrisë te njeriu, pra përsosmëria e qenies së njeriut, përsosmëri e cila manifestohet me ndjenjën e epshit, pra spermatozoidit e cila është mjet për të mbijetuar dhe për t’u shtuar qenia njerëzore. Sepse po të kërkonte Allahu para se t’i paraqitej epshi i brendshëm njerëzorë, atëherë kërkimi për me besua prej tij do të ishte kërkim jo i plotë (i mangët).

E po të kërkohet e ai nuk di për çështjen e ndjenjës së brendshme (epshit), atëherë kur do t’i paraqitej në trup diçka e re, atëherë pranimi i obligueshmërisë duhet të filloj rishtazi prej fillimit. Atëherë njeriu do të kishte thënë: E kam pranuar para se me ekzistua kjo çështje e brendshme, mirëpo Allahu ka dëshiruar që të pranohet obligimi pasi të vjen kjo ndjenjë e brendshme, që njeriu ta pranoj obligimin dhe përgjegjësinë pasi të plotësohet në tërësi si njeri, e mos me iu paraqit diçka e re pas asaj kohe.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe kur të arrijnë fëmijët moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje” .

EN-NURE 59

Pra këtu është fillimi i fazës së obligueshmërisë, pasi që çdo obligim e ka kohën, edhe koha e obligueshmërisë e ka fillimin e fazës e kjo fazë është pjekuria, e pjekuria është plotësimi i burrërisë së njeriut, e burrëria e njeriut është fillimi i kryerjes së obligimeve ndaj Allahut, e kjo nuk mund të arrihet vetëm atëherë kur ai është në gjendje me formua njeri, e kjo arrihet në epshin seksual, e cila është mjet për të lindur njeri tjetër, pra jetë tjetër.

PRAKTIKIMI I SHERIATIT

Pse deri sot nuk është praktiku Sheriati Islam?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Kjo pyetje duhet t'i parashtrahet drejtpërdrejt popullit sepse ai është i cili zgjedh ligjin në këtë vend. Kur i keni zgjedhur deputetët a mos keni bënë ndonjë krahasim kush premtun se do të gjykoj me librin e Allahut: Bazë kryesore për t'i zgjedhur deputetët është që ata me premtua se do ta praktikojnë ligjin e sheriatit. Unë edhe më herët kam thënë: ne nuk dëshirojmë që haptazi me thënë mendimin tonë për planprogramin e Allahut.

Mirëpo, unë dëshiroj prej juve që ju të kërkoni që kuvendi haptazi të deklarohet që nuk vendosin asnjë ligj njerëzor para ligjit të Allahut. Dëshiroj prej juve që kjo të jetë bazë kryesore me të cilin ju i krahasoni deputetët e juaj që me ju thënë atyre çka keni vendos ju për fenë tuaj në parlament. Kur të ndodh kjo, atëherë deputetët e kuptojnë se ata janë zgjedhur në bazë të kësaj çështjeje, pra për me vendos Ligjin e Allahut. Kjo është ajo që duhet të ndodh në këtë qytet, dhe se ligji i sheriatit duhet të filloj të praktikohet sa më shpejtë që është e mundur.

Lus Allahun që të gjithëve të na përkrahë dhe që të gjithë të jemi shëmbëlltjërë për të mirë të na dojë të mirë, të na bëjë që ta dëshirojmë të mirën dhe të na drejtoje në të mirën.

TË NDALUARIT E VRASJES SË BESIMTARIT

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s për njeriun i cili e ka zënë në pozitë të vështirë një idhujtarë për me mbytë.

Por ai i thotë: Unë jam musliman, por prapë e ka mbytë.

Mirëpo ai këtë fjalë e ka thënë vetëm për me shpëtuar jetën e tij.

Muhamedi a.s. ka thënë: Vërtet Allahu ma ka ndaluar mua me mbytë besimtarin.

CILI ËSHTË MË I HERSHËM PABESIMI APO BESIMI

Çka do të thotë pabesim dhe cili paraprin pabesimi apo besimi?

Shejh Shaëraviju thotë: Ai i cili shikon në pabesim, përfiton prej tij edhe pse nuk ka përfton me qenë vetë pabesimtarë, pasi që pabesimi ekziston tek njerëzit, pabesim do të thotë *fshehje*.

Pra, fjala e pabesimit është se besimi ekziston në brendësi, sepse pabesim do të thotë *fshehje*, pra mosbesimi në Allahun do të thotë fshehja e ekzistimit të Allahut. Për arsye se fshehja është dytësore ndërsa parësore është besimi në Zotin. Pra, vet fjala

pabesim vetvetiu është kundër pabesimtarëve, sepse nuk thuhet pabesim përderisa nuk ekziston diçka e pastaj e fshehim që tregon se imani (besimi) është natyrshmëri, pastaj është paraqitur fshehtësia e besimit për m'i indinjua njerëzit. Pasi që besimi nuk i le hapësirë udhëheqësit, sunduesit, pozitëlarët dhe shfrytëzuesit e pozitës.

Për këtë arsye kanë filluar me fsheh besim në Allahun. Pra, fjala në esencë tregon se pabesimit i ka parapri besimi.

Kjo është çështje e logjikshme, sepse njeriu i parë është Ademi. Ai i cili e ka krijuar atë është Allahu, Ai e ka frymëzuar me shpirt, i ka urdhëruar melekët me i bë sexhde dhe ia ka tregu rrugën e vërtetë.

Të gjitha këto tregojnë një çështje se pabesimi në fillim as që ka qenë, por nëpërmjet pabesimit Iblisi ka dëshiruar me mashtrua Ademin. Ka qenë e patjetërsueshme se Ademi iu ka sqaruar djemve të tij çka ka ditur, mirëpo me kalimin e kohës ka filluar harresa, dhe kështu shumica e njerëzve kanë filluar me mendua se besimi ua përkufizon jetën e tyre, e kanë filluar mos me besua, mirëpo i logjikshmi kur të dëgjon fjalën pabesim, duhet të jetë i kujdesshëm që mos i bashkëngjitet mendimit me fsheh të ekzistuarën për këtë arsye Allahu tërheq vërejtjen dhe pyet: po si po mohoni atë.

Ata nuk kanë përgjigje tjetër pos:

“Ne kemi fshehur besimin në ty o Zot”. Ky është besimi ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Po si po e mohoni Zotin kur nuk ka ekzistuar (keni qenë të vdekur) e ai ju krijoi (ju ngjalli juve).”

El Bekare, 28

Ky ajet tregon argumentin në besim. Allahu iu është përgjigjur natyrshmërisë së sendeve, ashtu që vepron në këtë e ajo reflektohet te Ai. E kjo është se Zotit të Lartmadhëruar i janë të nënshtruar të gjitha sendet çka ka në tokë, dhe me kalimin e kohës mendohet se ka lidhje mbi ngarkesat. Për këtë arsye në mendjen e njeriut jeton fuqia e shkaqeve. Zoti i Lartmadhëruar është Krijues dhe krijuesi i shkaqeve.

Nuk ka dyshim se imani i paraprinë pabesimit. E shfrytëzova rastin dhe kam pyetur imamin e nderuar edhe me pyetjen të cilën e bëjnë njerëzit me tallje. Cila është më e para veza a po pula.

Ai e cilëson këtë si mendjelehtësi prej mendjelehtësive të njerëzve të cilëve nuk logjikojnë dhe nuk mendojnë.

PSE NË KUR'AN KA AJETE TË PAQARTA

Pyetje: Pse në Kur'an ka ajete të paqarta?

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ai është i Cili të ka zbritur ty Librin (Kur'anin). Në të ka ajete plotësisht të qarta, të cilat janë themelet e librit dhe të tjerat jo krejtësisht të qarta. Kështu, sa për ata në zemrat e të cilëve ka largim nga e vërteta, ndjekin atë që nuk është krejtësisht e qartë, në këtë mënyrë ata dëshirojnë ngatërresa (i mosmarrëveshje e konflikte) dhe dëshirojnë kuptimet e fshehta, por askush nuk i di kuptimet e fshehta, pos Allahut dhe ata që janë të thelluar në dituri thonë: Ne besojmë të, i tëri (Kur'ani) është nga Zoti ynë. Këtë nuk e logjikojnë, pos atyre që kanë mendje të shëndoshë”.

(Ali Imran, 7)

Pyetje: Pse ka në Kur'an ajete të paqarta?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Të thelluarit në dituri thonë: ne kemi besuar Allahun, edhe pse nuk kuptojnë asgjë, sepse të gjitha janë prej Allahut. Pra, të paqartat prej Allahut dhe të paqartat prej Allahut. Dhe sikurse që syri e ka kufirin e të shikuarit, veshi kufirin e të dëgjuarit, ashtu edhe mendja e ka kufirin e të kuptuarit mendor.

Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Çka të kuptoni se është e qartë veproni me të, çka të kuptoni se është e paqartë, vetëm besojeni”. I Dërguari i ka folur të vërtetën.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ata të cilët besojnë e dinë se është e vërtetë prej Zotit të tyre, ndërsa ata të cilët mohojnë thonë: Po çka ka dashur Allahu të thotë me këtë (shembull)”.

Allahu i Lartmadhëruar ka dashur ta testojë dhe ta sprovtojë besimtarin. Sprovimi duhet të jetë i qartë se është testim.

Allahu dëshiron të dallojë të mirën prej të keqes, e Ai e di se çka është e mirë dhe çka është e keqe. Mirëpo dëshiron që edhe ti vetë ta vendosësh në praktikë, për të qenë argument për ty.

Ai e di, mirëpo Ai dëshiron dituri praktike dhe me dëshminë tënde. Sepse po të thoshte, me diturinë të cilën ti e posedon; ti ndoshta do të kishe thënë: Po të kisha pritur do të kishte qenë kjo, kjo, kjo ...

Kur'ani është një, mirëpo pranimi i tij është i ndryshëm. Kështu edhe pranimi i të gjitha fshehtësive dhe pranimi i të gjitha gjërave në të cilat barazohet mendja besimtari i pranon ato, sepse ato janë të vërteta dhe të drejta dhe janë prej të Drejtit dhe Vërtetuesit (Allahut), e kuptoi apo nuk e kuptoi ai.

Ky është shkaku pse në Kur'an ka ajete të paqarta. Kur'ani ka zbritur për të na sqaruar ligjet dhe dispozitat, ndërsa ajetet e paqarta të cilat janë zbritur në Kur'an janë zbritur për të vendosur imamin në peshojë. Pra në të janë ajetet e qarta dhe tjerat të paqarta.

KULMINACIONI I ADHURIMIT NDAJ ALLAHUT

Pyetje: Cili është kulminacioni i adhurimit të cilin duhet ta arrijë besimtari, me qëllim që të jetë i qetësuar dhe ta ndiejë dhe ta përjetojë kënaqësinë e Allahut vazhdimisht dhe pandërprerë.

Imami i nderuar thotë:

Po të kishte që çdo çështje që kërkohet për t'u vepruar dhe ajo çështje e ka arsyen dhe urtësinë e obligueshmërisë dhe të jetë i sigurt në atë, atëherë nuk do të kishte kuptim adhurimi i vërtetë. Mirëpo adhurimi është çështje që kur të pranon urdhërin prej Allahut pasi që t'i besosh Atij dhe t'i besosh plotësisht dhe me bindje të thellë se Ai është më i Urti dhe më i Mençuri, i Cili të drejton dhe të orienton në një veprim.

E pastaj nëse veç ti e ke pranuar atë urdhër me këtë qëllim, ti veç e ke arritur kulminacionin e adhurimit ndaj Allahut. E pas kësaj Allahu t'i zbulon ty fshehtësitë dhe sekretet e kryerjes së dispozitave dhe urdhrave dhe pasojat për moskryerjen e tyre. Ata të cilët kanë sqaruar urtësinë dhe arsyen e namazit, urtësinë dhe arsyen e agjërimit, urtësinë dhe arsyen e zekatit. Mu ata janë të cilën në rend të parë e pastaj e kanë kuptuar në veten e tyre se çfarë dobie u ka sjellë në veten e tyre dhe në shpirtin e tyre. Ata kanë treguar se kanë pasur këtë e këtë dobi.

Farzet e abdesit janë këto:

Pastrimi i duarve deri në bërryla, pastrimi i fytyrës, lëmimi (mes-hi) i kokës dhe pastrimi i këmbëve. Nëse njërin e pyet vetëm për këto çështje, e kupton se pastrimi i këtyre pjesëve ka arsyen dhe urtësinë, po ashtu, nuk ka dyshim se i Dërguari i di specifikat e ujit qarkullues dhe i cili nuk ka as erë, e as ngjyrë. Dhe kur njeriu e merr ujin në dorë dhe sheh se nuk ka ngjyrë kur të fut ujin në gojë dhe bën shpëlarjen e gojës, e kupton se nuk ka shije, kur ta vendosë në hundë ujin e kupton se nuk ka erë. Atëherë çka? Kuptohet se është ujë i përdorshëm dhe i vlefshëm për abdest. Pra kjo është ndoshta se shkaqet dhe urtësitë nuk vijnë para se të veprohet urdhri, por në rend të parë kryhet urdhri .

FEMRA DHE XHIHADI NË RRUGËN E ALLAHUT

A e ka për obligim femra me dalë me luftua në rrugë të Allahut.

Përgjigje:

Përderisa njerëzit luftojnë në rrugë të Allahut është e patjetërsueshme, pa pasur të vrarë, të plagosur e të lënduar në betejë.

Në luftë ka vend për të qenë edhe femra sepse kushtet nuk lejojnë që ajo me qenë indiferent kur të sheh se si tjerët vriten në rrugë të Allahut, si derdhet gjaku i muslimanëve si masakrohen apo torturohen, e pastaj ajo mendon për çështjet të cilat janë për mashkullin dhe çështjet të cilat janë për femrën .

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s në çdo luftë ku ka marr pjesë aty ka pasur edhe gra.

Zonja Umijete Bint Kajs pas kësaj ajo e ka vesh e ka mbajtur gjatë tërë jetës, kur ka vdekur ka lënë vasiet me u varros me të, gjë që e cila ka ndodhë.

Pra, kjo oshtë një çështje e cila paraqitet në dy raste specifike: në Haxh dhe në luftë në rrugë të Allahut.

Në Haxh njerëzit i luten Zotit të tyre, dhe mëkatet e mëparshme në tërësi u falen. Për këtë nuk dyshoj se ndokush të ketë mendim tjetër pos ajo që duhet të jetë.

Në luftë në rrugë të Allahut, në fushëbetejë ku gjaku derdhet, njerëzit vriten, gjymtyrët humben, zemrat digjen.

E kush është ai i cili mendon që ajo të mos merr pjesë.

LOGJIKA DHE ROLI I SAJ

Çka është logjika dhe cili është roli i saj, dhe kur njeriu hamendet në mes të dy çështjeve, a është prej çështjeve të logjikës, apo jo?

Shejh Shaëraviju thotë:

Logjika është shqisë me të cilën dallohet njeriu. Logjika nuk ka punë aty ku nuk ka çka të logjikohet. Roli i logjikës është vetëm me zgjedh mes çështjeve, pra në fushën e zgjedhjes.

Çështjet të cilat nuk kanë zgjedhje por ato kanë vetëm një mundësi, vetëm një rrugë, aty nuk ka punë logjika, mirëpo në çështjet ku ka dy e më shumë mundësi, atëherë ndërhyt logjika për të zgjedh çështjen të cilën e mendon se është më e përshtatshme.

Argument për këtë kemi, se kur mendja bllokohet, pra kur të çmendet njeriu, për atë njeri nuk ka obligim, pra hiqet obligimi prej tij, sepse në ato raste nuk ekziston mundësia e zgjedhjes, pra ai lirohet se nuk ka çka të zgjedh sepse është i çmendur.

FILLIMI I SUREVE ME SHKRONJA TË ALFABETIT

Dijetarët e mëhershëm dhe të sotshëm kanë diskutuar shumë rreth vendosjes së shkronjave të alfabetit arab në fillim të sureve.

Disa kanë thënë se janë shkronja tërheq-vërejtjes, thirrurë për t'u përgatitur i thirruri për të pranuar ajetet fisnike të cilat vijnë në vazhdim.

Të tjerët kanë thënë se shkronja "Kaf" është emërtim kodre, ndërsa disa shkronja tjera për qëllim emërtimin e disa sendeve lëndore.

Disa komentues mendojnë se: sepse këto shkronja janë përsëritur në Kur'an më shumë se shkronjat tjera.

Të tjerët mendojnë se janë shkronja logaritmike, pra thonë llogari të gjithësisë. Pra llogari në horizont, siç janë planetet, yjet dhe trupat tjerë qiellorë.

Dhe përderisa ka polemika rreth një çështjeje, kjo tregon për rëndësinë dhe problemin, apo rëndësinë e zgjedhjes së një problemi të madh. Posaçërisht kur dihet se

Muhamedi a.s. nuk ka fol për të dhe nuk e ka pyetur askush për këtë edhe kanë ardhur variante dhe mendime të ndryshme.

Kur e kam promovuar librin tim “Mrekullia mjekësore në Kur’an” për këtë çështje e kam pyetur Imamin e nderuar Shejh Shaëravijun, Imami i nderuar është përgjigjur: Dijetarët e parë e kanë ditur për fillimin e këtyre sureve me këto shkronja, për këtë arsye edhe nuk kanë pyetur për to, pse sikur mos ta kishin ditur kuptimin e tyre do ta kishin pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për to.

ME GURALECË ËSHTË MUNDUR USHTRIA E EBREHESË

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (1) أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ (2) وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا
أَبَابِيلَ (3) تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِنْ سِجِّيلٍ (4) فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَأْكُولٍ

El-Fijlë, 6

“A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit?
A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar?
Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë!
Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar!
Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!”.

Fjala “guralecë”. Guralecët a kanë qenë prej zjarri apo këtu ka të bëjë me mikrobet, të cilët e kanë shkatërruar ushtrinë e elefantëve të Ebrehesë?

Në librin tonë “Mrekullia mjekësore në Kur’an” për këtë çështje kemi diskutuar shumë dhe me përkushtim të madh.

Imami i nderuar nuk e pranon se bëhet fjalë për mikrobet, sepse po të ishte ashtu, atëherë mikrobet do të ishin shpërndarë në tërë Mekën.

Pastaj Imami pyet: Cili shpend i mençur fluturon vetëm në një drejtim të përcaktuar, duke dashur t’ia lehtësojë çështjet Allahut.

Pra, Shejh Shaëraviju mendon se kanë qenë guralecë të vërtetë, e është larg asaj që thuhet se kanë qenë mikrobe e jo guralecë.

HIPOKRITËT DHE DËNIMI I TYRE

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtetë hipokritët janë në pjesën më të poshtme të zjarrit.”

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Hipokriti njihet në tri cilësi: Kur të flet rrenë, kur të premtton tradhton, dhe kur t’i besohet diçka tradhton.”

Cila është e vërteta e hipokritëve?

Shejh Shaëraviju thotë:

Allahu tallet me hipokritët përderisa ata veç kanë thënë: Vërtet ne jemi duke u tallur.

Zoti i Lartmadhëruar i thotë hipokritit:

“Pasi që ke bërë hipokrizi dhe ke thënë me gjuhë atë që nuk e ke në zemrën tënde, atëherë do të merremi me ty, kështu do t’i marrim prej teje sendet që i thua haptazi dh do t’i vendosim me ligjet tona. Do të të lejojmë që ti të bashkëjetosh e me u martua me muslimanet, e me i trashëgua muslimanët, por me këtë e kemi për qëllim që ti të jesh i përgjithmonshëm në zjarr, në fund të fundit të xhehenemit. Ashtu siç ke vepruar ti o hipokrit, që haptazi ke qen ndryshe, e fshehtazi ndryshe, ashtu edhe ne haptazi veprojmë ashtu siç sillësh haptazi se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, pasi që thua: La i lahe il-lallah Muhamedun resulullah, pastaj në të llogarisim prej pabesimtarëve. A mos je ti o hipokrit vetëm ti lajkatar? Jo kurrsesi jo. Allahu është lajkatari më i mirë.”

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: *Allahu tallet*, sepse fjala “ISTIHLA” ka domethënien: nënçmim, tallje e poshtërim.

PUNA E CILA TË SHPIE NË XHENET DHE PUNA E CILA TË SHPIE NË XHEHENEM

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

Cila punë të shpie në xhenet?

Është përgjigj: sinqeriteti, pse sinqeriteti i robit të Allahut është mirësi, mirësia e shti të besojë, e kur të besojë shkon në xhenet.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.:

Cila punë të shpie në xhehenem?

Është përgjigj: Rrena, pse kur të rrenë robi mëkaton e mëkatimi e shtyn në pabesim, e pabesimi e shpie në zjarr të xhehenemit.

E ka fol të vërtetën i Dërguari i Allahut s.a.v.s

SUFEHATË-MENDJELEHTËT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: dhe nëse u thuhet atyre besoni ashtu siç kanë besuar njerëzit (tjerë)? Thonë: A të besojmë ashtu siç kanë besuar mendjelehtët ? Përkundra, pra ata janë me të vërtet ato mendjelehtët por nuk e dinë.

Cili është kuptimi i fjalës *Sefijh – Mendjelehtë?*

Shejh Shaëraviju thotë:

Sefhe do të thotë mendjelehtësi pra do të thotë paaftësi për ti kuptuar çështjet.

Mirëpo, kush është Sefijh-mendjelehtë: Ai i cili beson në Zotin e tij apo ai i cili nuk beson?

Pra... Nëse ju besoni (mendoni) se ato janë mendjelehtët, pse atëherë pse kërkoni prej vetvetes suaj që të besoni e të bëheni mendjelehtë? Edhe kjo është mendjelehtësi . . . edhe kjo është kundër argument për ta.

RRUGA E VULLNETIT DHE E VETËDËSHIRËS DHE RRUGA E PAVULLNETIT DHE IMPONIMIT

Në çdo çështje ku zhvillohet polemika dhe fillojnë kundërthëniet, shohim se islami për atë çështje e ka dhënë fjalën përfundimtare dhe definitive.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“... dhe mos harro pjesën e kësaj bote”

(El-Kasas, 77)

Po ashtu thotë:

“Ta dini se jeta e kësaj bote është lojë, aheng e zbavitje dhe zbukurim”.

(El-Hadidë, 20)

Nëse kemi për qëllim të themi jeta në ekzistencë është jetë e jovetëdëshirës dhe e jovullnetit ose jetë e vetëdëshirës dhe e vullnetit, atëherë jeta gjithmonë është epiqendër e këtyre dy çështjeve. Lëvizjet dhe aktiviteti, i cili ndodhë pa vetëdëshirë, lëvizjet që ndodhin me vetëdëshirë dhe në mes të lëvizjeve që ndodhin me vetëdëshirë ose i epet përparësi zgjedhjes së veprimit.

Jeta e lumtur e botës tjetër, apo kënaqësia në të është në atë masë sa ke qenë i sinqertë dhe sa ke qenë i vetëpërmbajtur në jetën tënde të kësaj bote. Bota tjetër nuk është temë e fesë, por është shpërblim për shkak të fesë.

Ata të cilët thonë se kjo botë është qëllim final dhe nuk ka asgjë pas saj, ne i kundërpërgjigjemi: Cili është faji i atyre të cilët përjetojnë dhembje, vuajtje e vështirësi për t'i bërë të lumtur të tjerët? Ku mbetet shpërblimi i tyre?

Nëse i shikojmë çështjet kështu, atëherë ata të cilët vuajnë për t'i kënaqur të tjerët janë më marroqët dhe më budallenjtë, sepse ata e kanë humbur ajo çka është kryesore në jetën e tyre, e ajo është çështja e kësaj bote, dhe nuk presin kompensim asgjë në atë që quhet bota tjetër.

IMPONIMI DHE LIRIA E VEPRIMIT - DËSHIRA DHE ZGJEDHJA E VEPRIMIT

Në të gjitha çështjet ku diskutohet dhe për ato çështje bëhet polemik e madhe, shohim se islami e jep mendimin definitiv dhe të qartë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Mos harro pjesën tënde prej kësaj bote.”

El Kasas, 77

Po ashtu thotë:

“Ta dini se jeta e kësaj bote është lojë, zbavitje e zbukurim.”

El Hadidë, 20

Nëse kemi për qëllim të deklarojmë për jetën me ekzistencë në përgjithësi pra lëvizjeve padëshirueshme dhe nënshtruesve dhe po ashtu lëvizjen e dëshirueshme dhe jonënshtruese pse jeta gjithmonë është fushë e dy lloje të lëvizjeve.

Lloji i parë: Lëvizjet të cilat ndodhin pa dëshirë.

Lloji i dytë: Lëvizjet që ndodhin me dëshirë, por dëshira prapë është në es gjërave në diskonim apo në ambient.

Ndërsa sa i përket botës tjetër, aty ka lumturi varësisht prej sinqeritetit dhe punës tënde në këtë botë. Bota tjetër nuk është çështje e fesë, por çështje e shpërblimit, respektivisht dënimit për shkak të fesë.

Ata të cilët thonë: Kjo botë është pika kryesore dhe nuk ka pas kësaj bote asgjë. Ne i kundërpërgjigjemi: Po çka është puna me ata të cilët mundohen në jetën e tyre vetëm e vetëm për t'u sjellë lumturi tjerëve. Ku do të shpërblehen ata?!

Nëse shkojmë sipas këtij parimi, atëherë ata të cilët e kanë vështirësuar jetën e tyre vetëm e vetëm për t'u sjellë lumturi të tjerëve do të ishin njerëzit më të çoroditur dhe më të çmendurit! Sepse ata një pikë të cilën e kanë pasur, pra këtë dunja, edhe atë e kanë humbur dhe nuk kanë kurrfarë kompensimi në botën tjetër.

BARAZIA E MASHKULLIT ME FEMRËN

Ata të cilët e ngritin zërin që femra të barazohet me mashkullin, pse nuk e ngritin zërin që mashkulli të barazohet me femrën?

Pra për me kërkua prej saj me punua punën e mashkullit. Ka qenë dashtë me kërkua që edhe burri me punua punën e femrës, se përndryshe bëjnë padrejtësi në peshojën e barazisë të cilën po e kërkojnë.

Nëse femra punon punën e mashkullit dhe mbetet prapë me i krye punët e saja të posaçme, pra të cilat i takojnë natyrës së saj. Kjo do të thoshte se ne e kemi ngarkuar dyfish.

Kështu, ata nuk kërkojnë barazim e saj, por përkundrazi ata kërkojnë me ngarkua më shumë, dhe me i bë padrejtësi. Nëse femra dëshiron drejtësi për vete, ajo do të shikonte ata të cilët kërkojnë barazi të saj me mashkullin, ajo çka është posaçërisht për të. Nëse ata dëshirojnë drejtësi që ajo të jetë e barazuar me mashkullin, ka qen dashur të kërkojnë që ajo mos të punoj punët e mashkullit, e mos me qenë fushëveprimi i saj në punët e lehta, jo të rënda dhe jo të vështira.

TRASHËGIMIA E MASHKULLIT DHE TRASHËGIMIA E FEMRËS

Pyetje: Pse pjesa e femrës është sa gjysma e pjesës së mashkullit në trashëgimi?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë: Ai i cili thotë ashtu i themi: Pse islami e ka zvogëluar pjesën e femrës nga pjesa e burrit në trashëgimi, duhet të shikojmë: Me këtë islami a ka anuar në anën e mashkullit apo në anën e femrës?

Në islam, para martesës për femrën, përgjegjësin për furnizim e ka burri i kujdestari i saj, ndërsa pas martesës përgjegjësinë për furnizim e ka burri i saj edhe nëse supozojmë se ajo është e pasur ndërsa burri i saj i varfër. A e detyron sheriatu që ajo ta furnizoj atë kur ai është i varfër? Natyrisht jo... Por ai merr borxh dhe nuk ka të drejt të ia merr asaj, pra femra nuk është furnizuese por e furnizuar si para martesës ashtu edhe pas martesës.

Nëse pjesën e trashëguar dy të drejtat ia japim vëllait të saj ndërsa një të tretën asaj. Burri e ka për detyrë ta ketë shtëpinë, të martohet, pra ta sjell bashkëshorten në shtëpi dhe të shpenzojë për furnizimin e saj pra për këtë ai ka të drejtë në dy të tretat me investuar për vetën dhe për bashkëshorten e tij, ndërsa motra e tij kur të martohen, nuk e ka për detyrë që ta furnizoj bashkëshortin e saj, e nga ky shkak një e treta është e destinuar për ta e një e treta tjetër jo. Ata të cilët pak logjikojnë ka qenë dashtë të supozojnë: femra nuk është furnizuese as para martesës, as pas martesës, ajo asnjëherë nuk është furnizuese e shtëpisë, e kjo është lehtësi për femrën...

USHQIMI I VËRTETË

Pyetje: Në vendet e zhvilluara përkundër jetës komode, përkundër kushteve të volitshme për jetë, përkundër civilizimit dhe zhvillimit bashkëkohor, prapëseprapë shohim se të rinjtë bëjnë vetëvrasje. Cilat janë shkaqet?

Imami i mirënjohur përgjigjet:

Suedia është prej vendeve më të zhvilluara dhe më të ngritura, ndërsa sipas statistikave numri më i madh i të rinjve, të cilët bëjnë vetëvrasje është në Suedi, në të cilin edhe dominojnë sëmundjet e çmendurisë dhe psikopatisë. Pse atëherë ata të bëjnë vetëvrasje kurse i kanë të gjitha kushtet më të volitshme të jetesës, mirëpo natyrisht ata kanë uri në çështje tjera.

Ai ushqen një pjesë të trupit të tij, mirëpo nuk e ushqen pjesën tjetër, e kështu ndodhë tronditja, sepse pjesët tjera të nevojshme të trupit nuk i ka të zhvilluara, të edukuara, dhe kështu nuk ndodhë harmonizimi mes tyre. Mirëpo besimtari i rrit dhe i zhvillon paralel të gjitha pjesët e trupit të tij. Nëse e merr një njeri dhe ia heq pjesën më të lartë të trurit të tij, ai bëhet plotësisht si kafshë dhe jeton e lëvizë dhe i ka sjelljet si të kafshës.

Pra, humaniteti i tërësishëm qëndron në pjesën më të lartë të trurit. Kafshët jetojnë të uritura, mirëpo ata edhe kur janë në atë gjendje nuk jetojnë në stresin e varfërisë, apo frikën e krizës ekonomike ata as që mendojnë për këtë.

Kafsha ngordh apo prit, ndërsa biri i saj para saj nuk ndien kurrfarë dhembje, as pikëllimin e ndarjes. Kafsha e di rolin të cilën i ka dhënë Allahu prej ndjenjave të cilat i bëjnë dobi e nuk e dëmton dhe nuk e brengos çështja kur sheh tjetrin duke vdekur. Në ato momente as që mendon për vdekjen e tij apo rrugën e cila e shpie në vdekje.

FJALA ALLAH NË GJUHËT E NJERIUT

Fjala e të Lartmadhëruar përfundon me shkronjën “ 4 - H”, e cila është shkronjë e kraharorit – gjoksit, kur të artikullohet vendnxjerrja e tij është prej brendësisë së thellësisë së njeriut.

Shumica pyesin se ka filluar përdorimi i fjalës Allah në gjuhën e njeriut.

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Po të kishte qenë fjala (Allah) çështje e cila nuk do të kishte ekzistuar, atëherë çështjet e paekzistuar nuk kanë emërtime të cilat tregojnë për atë çështje. Më e habitshme se kjo është se ti te të gjitha gjuhët mund të gjesh përdorimin e fjalës Zot, i cili është i ngjashëm me fjalën [. Është e patjetërsueshme se baza themelore e kësaj është te njeriu i parë të cilit ia ka mësuar Allahu. Allahu ia ka mësuar babës tonë Ademit a.s. pastaj është përcjellë gjeneratë pas gjenerate, e tek pastaj ka filluar kundërshtimi i njerëzve. Por parashtrahet pyetja pse?

Sepse njerëzit i kanë përcjellë fjalët të cilat tregojnë lëndët dhe nuk i kanë përcjellë fjalët të cilat tregojnë të padukshmet. Allahu është i padukshëm. Për këtë arsye në gjuhët tjera shohim se te filozofët fjala “mohim i Zotit” është argumentim në ekzistimin e Zotit. Pra, sikurse bazë është imani (besimi) e pastaj sekondare mohimi në Zotin.

Esenciale është se kjo fjalë iu është mësuar Ademit a.s. i cili pastaj ua ka mësuar bijve të tij. Esenciale është se kjo është natyrshmëri njerëzore. Andaj fjala Allah – Zot dhe fjala pabesim, që të dyja dëshmojnë në besimin në Zot, besimin në Allahun.

A KA PAS POLIGAMI PARA ISLAMIT ?

A ka pas poligami para islamit apo vetëm me ardhjen e islamit është ligjësuar poligamia?

Shejh Shaëraviju thotë: Islami nuk ka ardhur me parimin poligamisë, sepse poligamia veç ka ekzistuar edhe para islamit. Por islami ka ardhur për përkufizimin e poligamisë në 4 përpos te Pejgamberi s.a.v.s. sepse Muhamedi a.s. veç i ka pasur më shumë se 4. Muhamedi a.s. ka thënë: Mbaj 4 gratë dhe lëshoj të tjerat, gjë që tregon se poligamia ka qenë më shumë se 4 realitet. Ata të cilët nuk kuptojnë e akuzojnë islamin se e ka lejuar poligaminë, mirëpo e vërteta është se poligaminë e ka kufizuar. Mirëpo kundërshtarët e islamit kalojnë në çështje tjetër, e ajo është se Muhamedi a.s. nuk iu është përmbajt fjalës. Mbaj 4 dhe lëshoj tjerat. Për t’i mbajtur 4 në rregull, ndërsa për t’i mbajtur më shumë se 4 është ndaluar, mirëpo kjo nuk e ndalon asnjë femër që ajo të lidh kurorë me tjetër kënd dhe të martohet me tjetër në kufirin brenda 4 grave. Në ato qaste Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë i martuar me nëntë ndërsa ato momente kanë qenë momente ku gratë e Pejgamberit kanë qenë nëna të besimtarëve, dhe ka qenë e ndaluar që ndonjë prej besimtarëve të martohej me ndonjërin prej grave po ta kishte lëshuar Pejgamberi s.a.v.s. . Dhe pasi që asnjë nuk do të martohej atëherë patjetër të i mbante në martesë.

MJEKIMI

Një beduin e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. o i Dërguar i Allahut : A të shërohemi?

Përgjigje: Po sepse Allahu nuk ka zbrit sëmundje, e të mos e ketë zbritën shërimin, e mëson (e gjen) ai që mëson, dhe nuk e (gjen) e mëson ai i cili nuk mëson.

E ka rexhistru Ahmed

Në Sunen: Beduinët kanë pyetur: O Dërguar i Allahut: A të shërohemi?

Është përgjigjur: Po. O ju robër të Allahut shërohuni, se vërtet Allahu nuk ka lën sëmundje pa e pasur shërimin (ilaçin) përpos vdekjes (e cila nuk ka shërim).

Është pyetur s.a.v.s.

Si është puna me ilaçet që shërohemi në rukjet që shërohemi, dhe me preventivat që nuk lejojmë të sëmureni, a mos është kundërshtim me kaderin e Allahut?

Është përgjigjur: Po mu ajo është kaderi i Allahut.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. a ndikon pozitivisht mjekimi në sëmundje?

Është përgjigjur: Pse a mos Allahu i Lartmadhëruar ka zbritur sëmundje në tokë e të mos ketë zbritur mjekim (ilaçin) e shërimin të asaj sëmundje.

E ka regjistruar Ahmed

NDALIMI I IDHUJTARISË

Çka është “idhujtaria”

Përgjigje: Idhujtaria është të ekzistuarit e Allahut me ortakët e tij. Idhujtaria është dy llojesh: E para : Supozimi se janë dy luftëra dhe (kanë marrëveshje) janë në pajtim mes vete. E Dytë : Supozimi se janë në kundërshtim mes vete.

E para është bashkëveprimi i të dyve në një çështje

E dyta nëse janë në kundërshtim mes vete, paraqitet problemi i supozimit se a mund të realizohet apo jo? Ekzistenca Aksidenti ose mund të ekzistoj ose jo pse njeri dëshiron me krijuar diçka e tjetri jo, e nëse veç krijohet diçka atëherë ndodh humbja e atij i cili nuk ka dëshiruar me u krijuar diçka (ekzistenca) e nëse nuk krijohet diçka atëherë dështon ai i cili ka dashur me krijuar. Për këtë arsye në të gjitha rastet është i pamundur idhujtaria. Dhe me të (Allahun) nuk ka Zot tjetër, se atëherë do të shkonte secili Zot me atë që ka krijuar dhe do të ngritej njëri mbi tjetrin (El-Muëminunë, 91), e nëse ndodh kjo, atëherë do të dyluftonin mes vete, dhe njëri do të ishte i ngritur mbi tjetrin. Pastaj do të ndodhte revanshizmi në dy luftim e kjo do të ishte në kundërshtim me përsosmërinë absolute të Zotit. Idhujtarët e gjerë, kur të shohin diçka refleksive në gjithësi, si p.sh. Dielli mbi ta duhet ta dinë se ai i është nënshtruar Zotit, sepse ibadeti (adhurimi) ka kuptimin që robi me i krye urdhrat e Krijuesit, dhe epiqendër e ibadetit është planprogrami i Krijuesit me të gjitha ligjet dhe obligimet.

PROKLAMIMI

Çka është proklamimi dhe cili është rreziku i tij në shoqëri?

I nderuari imami Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Proklamimi është: vleftësimi i punës për shkak se nuk paguhet për atë që e ka punuar. Proklamuesi hulumton shpërblimin jomeritor, ai mund të kënaqet vetëm me një fjalë të njeriut tjetër, ndikimi në të është i cekët, e kjo është si rezultat sepse ai nuk shoqërohet shpërblimi i madh i punës të cilën e ka premtuar Allahu. Ai gjithnjë hulumton pjekjen e të keqes me shpejtësi, dhe shpërblimin e punës me shpejtësi p.sh. Largimin e vetës së tij për të mos përngjajë se është fetar ose me pas respekt dhe pozitë të dalluar tek njerëzit. Kjo është një shpërblim simbolik dhe i dobët në krahasim me shpërblimin e përgjithmonshëm të cilën e ka parapa Allahu për robërit e tij të sinqertë.

Esenca e proklamimit është: mendjehhtësia në përcaktimin e shpërblimit. Sipas sheriatit proklamuesi është besimtarë sepse Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: "Proklamohen para njerëzve, dhe Allahun e përmendim vetëm pak".

EN-NISA 142

PSE SUREJA "IHLAS" PAS SURES KJAFIRINË NASR DHE MESED

Pse është vendosur në Kur'an sureja "Ihlas" pas suretu Kjafirun, Nasr dhe Mesed?

Shejh Shaëraviju thotë:

Renditja e suretul-Ihlas pas suretu El-Kjafirun, En-Nasr dhe El-Mesed është renditje e domosdoshme, sepse e para i ndërpret marrëdhëniet plotësisht me pabesimtarë sepse ata janë të vendosur në pabesimin e tyre. E kjo ndërprerje e marrëdhënieve është bë nga ana e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. në ajetin. Nuk besoj atë që besoni ju dhe ajeti tjetër dhe unë nuk do të besoj atë që ju keni besuar. Kjo është domethënia e TEVHIDIT. Njëshmërisë dhe rrënjosja në zemër... Këtu ajeti vërteton ndërprerjen e marrëdhënieve me pabesimtarët në çfarëdo kushtesh dhe rrethanash. E me këtë kuptohet ndërprerje e marrëdhënieve, pra pranimin e kundërshtarit me fenë e tij si do që të jetoj. Mirëpo a vazhdon gjendja kështu? Vjen sureja "Nasr". Dhe kur vjen ndihma e Allahut dhe fitorja. Sinjalizon dështimin e pabesimtarëve dhe ziliqarëve. E kjo do të thotë se të gjithë pabesimtarët do të besojnë në fenë e Allahut. Për këtë arsye vjen në Kur'an përjashtimi, disave duke tregu disa prej tyre siç është rasti i Ebi Lehebit e të ngjashëm të cilët e luftojnë thirrjen islame, për këtë arsye është sureja Mesed "Ju thafshin duart(u mallkoftë) Ebi Lehebit ashtu siq ju kan thënë (paralizu). Sureja e tretë pas dy sureve të para për me bë përjashtim të disa pabesimtarëve të cilët me kufrin e tyre luftojnë besimin, e pas kësaj vjen sureja "Ihlas" për me vendos të vërtetën se bazë e atyre e ka u tha më parë prej ajeteve është Ai(Allahu) një i vetëm, dhe çdo gjë e ka u cek më lartë është fjalë e të vetmit Allah, e vërtetë dhe e pamohueshme, dhe e pandryshueshme. Kështu të gjitha suret janë të thura dhe harmonike mes vete ...

BUJQËSIA DHE OBLIGUESHMËRIA

Çdo obligim prej obligimeve të kësaj bote është i përcaktuar dhe i përkufizuar në të gjitha fetë qiellore për t'iu sjellë planprogrami i tyre lumturi qenies njerëzore, dhe mos të shkaktohet turbullira dhe trazira. Si qëndron çështja me suksesin në kryerjen e obligimeve.

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

FELEHA do të thotë: ndalje, ndërprerje, hekuri me hekurin prihet. Kjo domethënie shpie në kuptimin e aktivitetit i cili rezulton pjesën tjetër automatikisht.

Bujku kur ta punon tokën këtë e ka pasuar nga baba i tij Ademi a.s.

Mirëpo Ademi a.s. kur e ka punuar tokën, nga kush ka mësuar?

Ai ka mësuar prej Allahut, ashtu siç ia ka mësuar të gjitha emrat e ekzistencës. Rrënjët e shkencave janë prej Allahut, sepse Allahu nuk e ka krijuar Ademin që ta kryejë rolin e tij në tokë pa ia mësuar rregullat në të ose së paku ka mësuar fillimin e këtij roli dhe misioni.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“A e shihnit farën që ju e mbillni në tokë? A ju e bëni që të rritet apo Ne jemi Rritës dhe zhvillues së saj? Po të donim Ne mund ta shkatërronim e ta bënim pluhur, e ju do të ishit habitur e brengosur (pa shpresë).

Obligueshmëria e ngushton njeriun, mirëpo Allahu ia mëson njeriut se obligueshmëria e zgjeron njeriu, sepse ngushtësimi është në këtë botë kalimtare, ndërsa Zoti i Lartmadhëruar do të jep në botën tjetër të përgjithmonshme tokën, në të cilën ti mbjell një kokërr, prej saj ti pastaj i fiton shtatëqind kokrra. Pasi që toka është diçka e krijuar të jep fitim të shumëfishtë prej asaj çka i jep asaj. Po si është çështja me Krijuesin? A nuk të jep shumëfish nga ajo që jep ti?

NË NAMAZET E TYRE JANË PËRTACË

Pyetje: Pse disa njerëz përtojnë në faljen e namazit, kur dihet se Muhamedi a.s. ka thënë: “Namazi është shtyllë e fesë”

Po ashtu ka thënë: “Nuk i takon islamit lënësi i namazit”.

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë:

Disa prej njerëzve a nuk e falin namazin për atë se merr kohë e cila ju nevojitet atyre për punën e tyre e cila u nevojitet për jetë.

Nëse puna është kështu, u themi atyre: Në çka bazohet vlera e kohës?

Vërtet Zoti i Lartmadhëruar nëse e sheh se ti ke sakrifikua kohë e cila të është nevojiti për fitim të pasurisë, ti atë kohë që ke punua dhe ke ardhur me pasuri tek Allahu për me tregu adhurimin tënd se pasurinë të cilën e ke fitua me duart tua, duhet me nda një pjesë të pasurisë për vëllezërit tu të dobët, e për atë është ligjësua zekati.

VLERA E XHEMATIT

Në jetën islame xhemati ka vlerë të madhe. Adhurimi me xhematë është më i vlefshëm te Allahu se ai i vetëm. Dhe derisa sa Musa a.s. i ka thënë Hidrit: *“Nëse dëshiron Allahu do të jem **durimtar**.”* Ai nuk ka mundur të durojë, sepse ka thënë në njëjës **“durimtar”**. Ndërsa, ne shohim se Ismaili, kur ka qenë në pyetje për t’u bërë kurban, i ka thënë babës së tij: *“Nëse do Allahu do të jem prej **durimtarëve**”*. Për këtë arsye ai veç ka duruar. Sepse ka thënë në shumës **“prej durimtarëve”**. Kjo na tregon qartë vlerën e shumësit xhematit.

Për këtë çështje Shejh Shaëraviju na tregon se në namaz; kur ta këndojmë suretul *“fatihan”*, themi: *“Vetëm ty të **adhurojmë** dhe vetëm prej teje ndihmë **kërkojmë**”*. Pra muslimani thotë për vete dhe për tjetrin, edhe tjetri thotë për veten dhe për tjetrin, e kështu me radhë ...

Ti ndoshta nuk je i kënaqur dhe nuk të pushon zemra për punën tënde që e ke kryer te Allahu, mirëpo nëse është me xhematë, atëherë është e mundur që prej gjithë asaj mase, ndonjërit nga robërit t’iu pranohet te Allahu. E ti nëse iu ke bashkangjitur atyre me adhurim e lutje, atëherë kur Allahu t’ia pranojë xhematit në tërësi, ti veç je në mesin e atij xhemati ...

ZEKATI DHE ZHVILLIMI – SHTIMI I PASURISË

Si mundet me qenë zekati shtim i pasurisë, kurse zekati është dhëne, e dhëna e pakëson pasurinë e dhënësit. E si mundet me qenë pastrim i pasurisë?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë:

Zekati është shtim dhe pastrim. Është pastrim sepse zekat-pranuesi është i dobët, e sheh atë i cili është më i fuqishëm se vet. Atëherë atij i nxitën ndjenjat e tij dhe fillon urrejtja, xhelozia dhe zemërimi mbi ta, mirëpo kur ta sheh se njeriu të cilit Zoti i ka dhënë begati, pastaj prej asaj begatie ai e zgjat dorën dhe jep, ai në vete thotë: begatia e këtij njeriu më ndihmoj mua, kështu që ai e pastron zemrën nga zemërimi dhe urrejtja.

Zekati është shtim, sepse kur i pasuri i jep pasuri, ai veç e ka zhvillu aktivitetin e jetës me atë pasuri, po ashtu ai tregohet se është i barabartë me shoqërinë në besim, sepse ai nuk e sheh perspektivën me vëllezërit besimtarë përreth.

Pra atë nuk e preokupojnë ngjarjet e jetës, e përderisa me të jetojnë vëllezërit e tij besimtarë. E mira të tjerët është kënaqësi për të. Shtimi i pasurisë realizohet me burrërinë e tij, me fuqinë e tij dhe personalitetin e tij.

Mirëpo, nëse njerëzit tërhiqen nga ai, ai ballafaqohet me jetën e tij me vetën e tij, sepse ai atëherë jeton i vetmuar... dhe i vetmuar nuk mund ta arrijë shtimin e pasurisë të cilën e kërkon, dhe nuk ka shpresë dhe lumturi në jetën e tij.

PENDIMI

Pyetje: Cila është urtësia e ligjërimit të TEVBES, dhe pranimi i pendimit prej Pendim-pranuesit. Falësit të gabimeve.

Përgjigje: Imami i njohur thotë:

Ligjësimi i pendimit, pranimi i faljes prej Zotit të Lartmadhëruar ka ardhur me siguri dhe me mbrojt rrugën e udhëzimit në tokë, sepse po mos të ishte ligjësuar pendimi atëherë aksidentalisht po të binte njeriu në mëkate atëherë ato mëkate do të kishin qenë pengesë pastaj që ai me u kthye në rrugë të drejt, dhe do të kishte vazhduar me mëkate, ashtu që do të pësonin trazirat dhe shkatërrinat në tokë. Sepse vetëm prej një lëshimi apo vetëm të një mëkati do të dëboheshin njerëzit prej mëshirës së Allahut dhe nuk do të shpresonin me u kthye në gjendjen e mëparshme pra të pastër prej gabimeve. Pra pse me u kthye në planprogramin e lirive dhe epsheve të kufizuara pasi që një mëkat do ta dëbonte ata nga mëshira e Allahut.

Paramendoni, sikur ndonjëri të bënte mëkat dhe të humbte shpresën me ia pranua Zoti tevben.

Si do të kishte me veprua ai?

Ai do të vazhdonte dhe të mëkatonte më shumë, do të bënte padrejtësi më shumë, do të bënte krime më shumë, e pastaj do ti mashtronte edhe tjerët në rrugën e tij të keqe, e atëherë e tërë bota do të bëhej me të këqij, do të paralizohej jeta, sepse askush nuk do të mund t'u kundërvihet atyre, pra ligjësimi i tevbës prej Zotit është hapje e rrugës për tu kthyer nga rruga e lakuar në rrugë të drejtë.

Për këtë arsye, Allahu arsyeton njeriun me gabua për shkak të harresës apo pakujdesisë.

Arsyetimi është sepse njeriu ndonjëherë dobësohet kur të bën mëkat, por kjo nuk llogaritet prej çështjeve të mëkatimit dhe Allahut i cili gëzohet me tevben e robit mëkatar i cili e ka humb devenë e tij dhe e deveja e ka lënë të humbur në shkretëtirë.

E gjithë kjo për të mbrojt dhe sigurua ekzistencën.

NË PAAFTËSI KA URTËSI

Disa persona kanë aftësi të kufizuara, për këtë arsye janë një pjesë e shoqërisë me të meta fizike. Nëse i numërojmë të paaftit apo njerëzit me aftësi të kufizuara na del se

proporcioni është një me mbi dhjetëmijë (Aftësi të kufizuara quhen të çmendurit, të verbëritë, kaluesit).

Pra numri i tyre është i vogël pra në krahasim me të aftit është shumë shumë i vogël. Këtë e ka përcaktua Allahu në gjithësi për me ua tërhequr vërejtjen harrestarëve për të mirat dhe begatitë që ua ka dhënë Allahu atyre.

Ti nuk mund ta dish të mirën e syve ku deri sa ta pashë një të verbët, tek atëherë i kthehesh vetes tënde. Ti nuk mund ta dish begatin e këmbëve tua deri sa të pash ndonjë njeri pa këmbë, pse tek atëherë e sheh aftësinë e këmbëve që të ndihmojnë me lëvizë pa kurrfarë mundimi. Reflektimi në trupin tënd, në mendjen tënde vjen atëherë kur ta pash një njeri i cili nuk mund të lëviz sipas dëshirës së tij.

Pra ai nëse dëshiron me lëvizë por nuk mundet ashtu siç dëshiron pra nervat e pjesëve të trupit nuk janë në gjendje ti aktivizojnë ashtu siç aktivizon rryma mjetin. Pra njerëzit me aftësi të kufizuara i ka parapa Allahu që të jenë në numër simbolik për me nxit me i përkujtua begatit e trupit tënd, mos me i harru të mirat e Allahut por me qenë ata shembuj praktik.

FAJI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ÇËSHTJA E SPROVIMIT TË TYRE

Pyetje: Pasi që jeta në këtë botë, me të gjitha bukuritë dhe kënaqësitë w e saj, ndërsa në anën tjetër personat me aftësi të kufizuara nuk ka dyshim se ndiejnë veten të mangët në realizimin e kënaqësive, lumturisë dhe përjetimin e kënaqësive të cilat të tjerët i përjetojnë dhe i realizojnë. Cili është faji i personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të të metave fizike nuk mund ta realizojnë një pjesë të madhe të kënaqësisë së kësaj bote?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Zoti i Lartmadhëruar ka zgjedhur disa njerëz për të qenë mostër te të tjerët.

Cili është faji i aftësive të kufizuara në këta njerëz ose p.sh., cili është faji i të verbëtit? Pastaj ta tërheqë vërejtjen dhe përgjigja është:

Ti po e sheh se çka i mungon (çka nuk iu është dhënë), mirëpo ti po harron se çka posedon ti, çka të ka dhënë Allahu ty përballë tij apo në krahasim me të. Nëse e shoh njeriun me të meta fizike p.sh., dhe i analizon të gjitha begatitë tjera të pjesëve fizike të tij do të shohësh se Allahu i ka dhënë atij diçka tjetër, me fjalë tjera ia ka kompensuar në pjesë tjera, atë çka i mungon në një pjesë të trupit . Është verbëruar njeriu ndërsa mprehtësia e mendjes është në të mbyllurit e syve.

Dhe u mahnita kur pashë se ai është kompletuar për dituri. Humbja e bebëzave të syrit iu kishte bërë udhëheqës i mendjes.

Diturinë të cilën tjerët nuk e kishin ai ua mësonte.

Ne e dimë se shumica e zbuluesve kanë qenë të pa aftë në disa apo në një pjesë të trupit të tyre.

Ne po ashtu shohim gjenialitet, të cilën dhunti ua jep Allahu në vetë pjesën, hapësirën, apo vetë organin e tij fizik, i cili është i kufizuar në aftësi të tij.

Kur Allahu njeriut i mungon (nuk i jep) diçka në një pjesë të trupit të atij personi Allahu ia jep aftësinë e dyfishtë ose të shumëfishtë në pjesën tjetër të trupit të tij. Kështu tërësia e çdo njeriu është e barabartë me njerëzit tjerë. Mirëpo përfundimisht njerëzit dallohen njëri me tjetrin vetëm me devotshmëri.

E VËRTETA E TEVEKULIT (MBËSHTETJEN NË ALLAHUN)

ET-TEVEKUL dhe TEVAKUL janë dy fjalë që i përdorin njerëzit, ndërsa kuptimin e tyre nuk e dinë shumica prej tyre.

TEVEKULI gjithmonë është fjalë që ka të bëjë me angazhimin e një pune të mundimshme, mirëpo i bindur dhe i sigurt se shpërblimi dhe pagimi i takon punëkryersve, dhe sa shpërblimi i mirë i punëkryersve.

Ndërsa “TEVAKUL” është prej tjetrit në tjetrin, pa u angazhuar dhe pa punuar për jetë.

Pyetja është: Cila është e vërteta e TEVEKULIT?

Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Vërtet besimi është me zemër dhe me trup dhe derisa trupi punon zemra duhet me u mbështet në Allahun (TEVEKUL KALBIHI).

Trupi punon e zemra mbështet, ky është parim i besimtarit.

Ndërsa ai i cili mendon apo parafytyron se TEVEKUL do të thotë anashkalim prej pune, dhe thotë se Allahu na furnizon ashtu qysh furnizon shpendët. Ne u themi atyre : Shpendët nuk janë të obliguar me mbjellë, puna e tyre është me u ushqye dhe me vazhdua fluturimin e tyre (e jo me u ndal me mbjell). Për këtë arsye atyre të cilët dëshirojnë që *tevekulin* ta bëjnë profesion u themi “Do ta vendosim tryezën, në të do të vendosim ushqim të shijshëm dhe të shohim *tevekulin* tënd. Pra ti mos e zgjat dorën në tryezë fare, e ne të shohim se a mos po kërcen ushqimi drejt në gojën tënde ! ?

Ata të cilët thonë ashtu, vërtetohet se janë rrenacak sepse e vërteta e *tevekulit* është me angazhua (lodh) trupin tënd e me qetësua zemrën tënde.

MESXHIDI AKSAJA E DIKURSHME

Mesxhidi Aksaja a ka qenë Mesxhid, kur dihet se më herët Muhamedi a.s. nuk është falur në të, dhe nuk ka qenë Mesxhid në kuptim të fjalës.

Imami i mirënjohur ka thënë:

Çka do të thotë Mesxhid?

Mesxhid është kuptim i vendit ku bëhet sexhdja. Sexhdja ka qenë veprim apo ligjësim i të gjitha shpalljeve. Mirëpo ka dallim në mes të rrënjës së fjalës, dhe veprimit me ato fjalë, me fjalë tjera kuptimit terminologjik të saj. Pra fjala Mesxhid a është objekt dhe vend i posaçëm. Mesxhid quhet çdo vend ku i bëhet sexhde Allahut, mirëpo pastaj atë vend e quajmë Mesxhid, vendsexhde ndaj Allahut.

Argument për këtë kemi fjalën e Allahut të Lartmadhëruar:

“O Mejreme, vërtet Allahu të ka zgjedhur dhe të ka pastruar, të ka zgjedhur e të ka dalluar mbi të gjitha gratë e botës. Oj Mejreme nënshtroju Zotit tënd bën sexhde dhe falu (bjer në ruku) me falësit.”

Pra sikurse dëshirohet të tregohet se sexhdja ka ekzistua edhe në shpalljet e mëhershme.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar na tregon ngjarjen e strehuesve të shpellës ku thotë: Do ta marrim atë vend si Mesxhid. Pra sikurse dëshirohet të tregohet se fjala Mesxhid nuk ka

ardhur me islamin, por përdorimi i kësaj fjale është përdorur dhe është përhapur në këto vende paralel me Islamin. Me fjalë tjera çdo vend ku i bëhet sexhde Allahut është *Mesxhid*.

Ajeti thotë:

Kemi thënë se: Mesxhidi Harami është shtëpia e parë e cila është vendosur për njerëzimin. Duhet ta kemi parasysh atë se disa njerëz kanë thënë se Ibrahim i a.s. e ka ndërtuar atë.

E ne u themi atyre: Jo. Qabja veç ka qenë e vendosur për njerëzimin. Pasi që veç ka qenë e vendosur për njerëzimin. Kjo do të thotë se vendosësh ka qenë jashtë qenies njerëzore dhe kur veç janë krijuar njerëzit e Ademi ka qenë njeri, patjetër mbetet alternativa se ajo është shtëpia e Allahu, dhe patjetër që ajo ka qenë e vendosur para Ademi. Siç është ajeti Kur'anore. Vërtetë shtëpia e parë e cila është vendosur për njerëzimin. Ademi është njeri, fëmijët e tij janë njeri, dhe ata të cilët hyjnë në të dhe sillen rreth saj me qenë prej njerëzve se për ta është vendosur, mirëpo Ibrahim vetëm i ka ringritur themelet, pra i ka lartësua themelet e shtëpisë.

Duhet ta dimë edhe atë se Ismaili a.s. i ka ndihmuar babës së tij, Ibrahimit, në ngritjen (lartësimin) e themeleve të shtëpisë.

“Dhe përkujto kur i ka ngritë Ibrahim themelet e shtëpisë dhe Ismaili.”

Ismaili i ka ndihmuar babës së tij me e rindërtua, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar na tregon në një ajet tjetër:

“O Zoti im vërtetë unë vendosa pasardhësit e mi në bregoren e cila nuk ka bimë e as pemë, por që aty është shtëpia jote e Shenjtë. O Zoti im për të falë ata namaz.”

Pra, Haxherja dhe biri i saj në gji kur janë dërgua aty, mirëpo aty nuk e kanë pa Këmbën e ngritur, por ka qenë i njohur se shtëpia e Allahut ka qenë aty para se me i ringritur Ibrahim themelet e shtëpisë së shenjtë. Pra shtëpinë nuk e ka vendosur Ibrahim dhe nuk është projekt dhe ndërtues nismëtarë Ibrahim. Mirëpo shtëpia ka qenë para Ibrahimit dhe Ibrahim vetëm i ka ringrit themelet.

PREJ MESXHIDI HARAMIT NË MESXHIDI AKSA

Në suretul isra Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Qoftë i Lartësuar Ai i cili e ka bartur robin e tij për një pjesë të shkurt nate prej Mesxhidi Haramit e deri në Mesxhidi Aksa, të cilin e kemi bekua atë dhe periferinë e tij. Pse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Prej Mesxhidi Haramit e deri në Mesxhidi Aksa?”

Shejh Shaëraviju thotë:

Sepse Qabja ka qenë e përcaktuar si shtëpia prej shtëpive të Allahut. Mirëpo ia kanë ndërrua këtë destinim dhe e kanë quajtur shtëpia arabe, dhe është mbushur me idhuj, ndërsa shtëpia e Kudsit, e ka pas shenjtorin e tij prej Musaut, Isaut dhe pejgamberëve tjerë te beni israilët.

I dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk është dërguar vetëm për popullin e tij, pra nuk është dërguar posaçërisht për arabët, siç pretendojnë ata. Jo, është peygamber ndërkombëtar. Udhëtimi për një pjesë të shkurtë të natës prej Mekës në bejtul Mukades, do të thotë përfshirjen e bejtul Mukadesit prej vendeve të shenjta në fenë e re. Ky akt sqaron se feja e tij është dëshmuar dhe vërtetues i të gjitha vendeve dhe i të gjitha vendeve të shenjta, për këtë arsye në namaz në fillim të obligimit kthimi ka qenë në drejtim të tij. Që mos me thënë askush se ju e keni fenë tuaj e ne e kemi fenë tonë. Jo, s'është e vërtetë. Është e vërtetë se feja jonë ka zbrit në Meke mirëpo është vërtetues i peygamberëve të mëparshëm dhe i Dërguari ynë është vërtetues i të gjitha vendeve të shenjta, e nga këtu bejtul Mukades është prej vendeve tona të shenjta sepse ka qenë vendi i fundit i Israsë dhe vendi i parë i Miëraxhit të Muhamedit s.a.v.s.

ÇKA ËSHTË SIDRETUL MUNTEHA?

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) tek Sidretul Munteha”.

(En-Nexhm, 13, 14)

Është e vërtetë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka shkuar në Sidretul Munteha. Mirëpo pyetja është: Pse nuk na ka ardhur tekstualisht?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Kanë thënë: Kjo është mëshirë e Allahut ndaj krijesave të tij. Çështjen të cilën i dërguari i Allahu ka mund ta paraqes me argument lëndor për njerëzit ka ardhur tekstualisht dhe qartësisht, që të mos ketë vështirësi i Dërguari i Allahut për ta transmetuar. Ndërsa i përket çështjeve të cilat mendja ndalet në to dhe i percepton. E ka lënë që të jetë në besimin dhe Imanin tënd, apo dorëzimi yt paraprak, i cili është rezultat i Imanit, sepse përderisa ti je besimtar, do të thuash: Pasi që ka ndodhur dhe është krijuar kjo dhe kështu të cilën e di, atëherë mund të krijohet kjo dhe ajo të cilën nuk e di, sepse çka më ka ndodhur diçka e zakonshme, mund të më ndodhë edhe e jashtëzakonshme, çfarë pengese ka këtu ligji. Pse ligjet qiellore për Zotin, a mos janë të vështira, të paarritshme, ndërsa ligjet e tokës të lehta dhe të arritshme në raport me ligjet qiellore!!

Pse, mos vallë me mrekullitë me të cilat Zoti i Lartmadhëruar i ka përforcuar pejgamberët s.a.v.s. a mos janë diçka tjetër, pos diçka të jashtëzakonshme dhe jashtë ligjeve, të cilat Ai vetë i ka paraparë. Pra, është shumë e zakonshme që Ai i ndryshon ligjet e Tij të zakonshme.

Atëherë, është gjë normale t'i ndodhë edhe të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. . Ta marrim shembull, kur ndonjë filozof thotë: Është e vërtetë, unë besoj se është një Zot, i Cili ka krijuar gjithësinë. Mirëpo unë i them Allahu është Ai i Cili ka krijuar gjithësinë. Krijimi i ligjeve dhe mos krijimi i ligjeve është që secili kryen detyrën e vet, pra ligjet janë ata të cilët veprojnë. E kjo do të thotë se Allahu fuqinë e Tij e ka vendosur mbi pushtetin e Tij përnjëherë, ka krijuar ligjet, pastaj ka paraparë që ata ligje të praktikohen dhe të ekzekutohen, por dëshira e Allahut është që ato ligje t'i ndryshojë në disa raste apo më shumë se në disa raste, e kjo vetëm që ta kuptojmë se përmbi ligjet natyrore dhe të zakonshme është Krijuesi i ligjit, i cili ka mundësi që atë ligj ose ta pezullojë, ose ta paralizojë.

Për këtë arsye ndodhin mrekullitë mbinatyrore. Të gjitha mrekullitë mbinatyrore, të cilat i janë dhënë të Dërguarve të Allahut të gjitha janë ndryshim të ligjeve natyrore. Se përndryshe ligji ujit është të qarkullojë, e qarkullimi i tij nuk mundet të jetë mrekulli mbinatyrore, por ligj natyror.

Nuk ka që një ujë të ketë ligj të qëndrojë kështu (teposhtë), ndërsa tjetri ujë të ketë këtë ligj të qëndrojë ashtu thik përjetë. Kështu që Musa a.s. kur i ka rënë ujit të detit dhe deti është ndarë dhe është bërë si të ishte në dy pjesë (ndërtesa- penda) të larta. Kjo është pra ndryshim i ligjit (mrekulli mbinatyrore).

Ligji i zjarrit është për të djegë, Ibrahim i është hedhur në zjarr. Qëllimi nuk ka qenë që të shpëtohet Ibrahim, sepse Ibrahim a.s. ka mund të shpëtojë. Edhe ndryshe, për t'iu ikur atyre ose Allahu ka mund të dërgojë shi rrebesh për ta fikur zjarrin. Mirëpo qëllimi ka qenë që Ibrahim të hidhet në zjarr që të digjet, mirëpo ligji i zjarrit ndezës është pezulluar, është paralizuar dhe nuk ka djegur.

Kështu është rasti i Miëraxhit. Kush është Ai, i Cili e ka ngritur në qiell për të pa shenjat e tij? A do ta pyesin Muhamedin a.s.: Na përshkruaj Sidretul Muntehanë? Ata as që kanë dëgjuar dhe as që dinë diç për të, dhe as që dinë çka të pyesin për të? Zoti i Lartmadhëruar në rend të parë e ka bartur robin e tij prej Mesxhidi Haramit në Mesxhidi Aksa për një pjesë shumë të shkurtër nate (Israja) për të qenë argument lëndor, sepse ai udhëtim është udhëtim tokësor, dhe kjo mrekulli është i treguar tekstualisht në ajet të qartë, pastaj ia ka dhënë mrekullinë qiellore, i cili është Miëraxhi për obligueshmëri ... Për këtë arsye dijetarët kanë dhënë mendimin se: Ai i cili mohon Isranë është pabesimtar, sepse ai bie ndesh me tekstin kur'anor. Ndërsa ai i cili mohon Miëraxhin nuk është pabesimtar, por është mëkatar, sepse Israja është me ajet të drejtpërdrejtë dhe i treguar tekstualisht, ndërsa Miëraxhi në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, pra me tregues indikacioni për t'iu përmbajtur.

ËNDRRA DHE JOËNDRRA

Ajetet të cilat përshkruajnë ngjarjen e Israsë dhe Miëraxhit i shohim se si ndonjëherë thuhet “ për me ti tregu argumentet tona, pastaj në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ai veç ka pa prej argumenteve tona të mëdha”. Pra njëherë me ia tregu, ndërsa

herën tjetër “veç i ka pa”. Pra e para herë procesi i shikimit të direkt, herën tjetër procesi i shikimit indirekt.

Për këtë çështje Imami i nderuar thotë:

Kjo çështje e cila nevojitet shikimin e ndodhisë, po ashtu edhe vet shikuesin. Ne e dimë p.sh. Ndodhinë kur Muhamedi a.s. ka zgjedh në mes të alkoolit dhe qumështin, pastaj ndodhinë e shpërblimit të muxhahidinëve, ndodhin se si përfundojnë ata të cilët e hanë pasurinë e jetimit, ndodhinë e përfundimit të vepruesit me kamate. Pastaj çështjet tjera të cilat i ka pa: siç janë sëmundjet shoqërore, dhe dukurit negative të moralit në shoqëri. Për të gjitha këto çështje duhet diskutua veç e veç. Po ashtu e dimë se Muhamedi a.s. është bë Imam i peygamberëve, duke mos harruar faktin se shumica e peygamberëve me të cilët është taku Muhamedi a.s. kanë qenë peygamber te Beni Israilët, pastaj çështje që Muhamedi a.s. disa herë ka shkuar te Musa a.s. pastaj prapë te Zoti i tij, përkundër asaj se hadithet janë të sakta, disa kanë thënë se nuk janë të sakta.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

Kur ia ka zbrit Zoti i Lartmadhëruar këtë ajet fisnik për ndodhitë e Israsë, ka qenë “për me të tregu” pra për me ia mundësua me pa, e çka do të thotë “me pa”. Shikim do te thotë: “me ia mundësua me pa”. E kjo do të thotë: ose shndërrimin e shikuesit në ligjet e të shikuarit ose sendet e para me i shndërrua ne ligjin e shikuesit.

PSE POPULLI ANALFABET ËSHTË PËRGATIT PËR TA PRANUAR MISIONIN E ISLAMIT?

Kjo është një pyetje e cila i ka preokupuar shumë komentues, dhe shumica janë habitur, pse Umetin analfabet Zoti e ka parapa me pranua shpalljen e Allahut dhe planprogramin e tij, e pastaj me u shpërnda te të gjithë popujt e botës.

Shejh Shaëraviju thotë:

Allahu e ka përgatitur gadishullin arabik për ta pranuar shpalljen, ky gadishull ka qenë analfabet, sepse Allahu nuk ka dashur që me fillua përhapja e fesë prej popullit të zhvilluar. Sepse do të thuhej pastaj se: Feja është përhap për shkak të zhvillimit të atij populli se përndryshe nuk do të përhapej.

Allahu nuk ka dashur që Islami të përhapej ashtu sepse do të ishte thënë imponim me dhunë të vendeve të zhvilluara, por ka dashur që islami të burojë prej pejgamberit analfabet dhe umetit analfabet që me ditë të gjithë njerëzit, se për çdo gjë që është në mesin e tyre nuk është prej tyre por vetëm prej Allahut.

Për këtë arsye duhet ta dimë se ata të cilët kur flasin për analfabetizmin e Muhamedit a.s. thonë: Këtë fjalë duhet ta fshijmë dhe nuk duhet te thuhet: “Pejgamberi analfabet i popullit analfabet”, ndërsa ne u themi atyre: Keni mendjen dhe zgjohuni prej kllapisë se Allahu ka dashur me i tregu botës se Muhamedi a.s. dhe umeti i tij nuk kanë marrë asgjë nga civilizimi i kësaj bote, por i tërë planprogrami i tyre ka ardhur prej qielli, dhe askush nuk ka thënë asgjë prej vetes së tij, as Pejgamberi të cilit i ka ardhur shpallja, e as populli të cilëve u ka ardhur shpallja.

HURITË E XHENETIT

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe ne i martuam ata me hyritë e Xhenetit”

Pasi që kontaktimi seksual po ndodhë në xhenet, ndërsa ajeti tjetër:

“Dhe për ta ka bashkëshorte të pastra”.

Patjetër duhet të jetë e tërë mënyra e kontaktimit seksual ndryshe nga ai i kësaj bote, sikurse ajo e alkoolit në xhenet, hiqet cilësia e dehjes, të cilën cilësi e ka në këtë botë.

Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë, pasi që disa thonë se ky proces dhe kjo dukuri është e neveritshme dhe e fëlliqur, e si të jetë në xhenet.

Imami përgjigjet:

Kjo është kënaqësia më e madhe e jetës prej kënaqësive shpirtërore. Mirëpo ti mos e shiko vetë procesin ose gjërat përgatitore të procesit, por shikoje përfundimin e procesit. Para se të kryhet procesi paraqitet gjëja më e lezetshme dhe kënaqësia më e madhe dhe mbetet kënaqësia dhe pas kësaj nëse ke fëlliqur diçka, pasi që veç je zbrazur, pra fëlliqësira bëhet në momentin e zbrazjes, atëherë gjërat para procesit të dashura në këtë nuk ka dyshim, vetë procesi i dashur. Por çka është ajo që e ka bërë të neveritshme deh të fëlliqur? Është ajo çka vjen pas atij procesi. Kjo është cilësinë e cila vjen pas kënaqësisë në këtë botë. Pra nuk duhet shikuar dhe nuk duhet krahasuar çështje me realitetin (ngjarjen) e tyre në këtë botë.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe vajza të reja të të njëjtës moshë”.

Mos thuaj ti se kjo çështje kaloi në seksualitet. Dhe është për t’u habitur pse të thuhet “kjo fjalë është e ndyrë, e si kjo të ndodhë në xhenet”, kur kjo është çështja e cila është prej më të parëve të njerëzimit, dhe çështja më e rëndësishmja në këtë botë, dhe çështja për të cilën më së shumti bëhet interesimi dhe angazhimi.

Pse po e njolloni?

Ajo është kënaqësi e vërtetë në fazën e parë të procesit, kënaqësi e vërtetë gjatë vetë procesit. Nëse diçka është fëlliqur është fëlliqur pas saj. Pse atëherë nuk po thua se Allahu do ta heqë cilësinë e fëlliqjes së saj, ashtu siç e heq dehjen prej alkoolit.

“... prej të cilit (alkool) nuk do t’u dhemb koka dhe nuk do t’u humb mendja (nuk do të dehen)”.

Pra cilësia e dhembjes së kohës dhe e humbjes së mendjes dhe vetëdijes do të hiqet.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet për të devotshmit janë përgatitur vende kënaqësie, kopshte e vreshta, dhe vajza të reja të të njëjtës moshë”.

“Keab – vajzat e reja”, pra vajzat të cilat nuk e kanë humbur virgjërinë e tyre.

“Etraba” pra të gjitha të një moshe, që të mos thuash kështu e ashtu, kjo apo ajo.

Çështja është se të gjitha janë të njëjta.

SI DO TE VEPROJ ZOTI ME NEVE KUR TA SHOHIM ATË

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. si do të veproj Zoti ynë me neve kur do ta takojmë në ditën e kiametit?

Përgjigje: Ka thënë: do të paraqitemi të gjithë para tij në një fushë ku secili nga ju do të jetë para Tij, atëherë Zoti yt (i Lartmadhëruar) do të merr ujë dhe do të hedhë para jush. Për Zotin tënd: fytyra e secilit prej juve patjetër do të nënshtrohet prezencës së tij.

Sa i përket muslimanit fytyra e tij do të jetë e shndritur vezulluese dhe e bardhë, ndërsa pabesimtari do të jetë e kërrusur dhe e nxjerr zi sikur qymyri.

E ka regjistrua Ahmedi

HAXHI I FËMIJËS PËR PRINDIN E TIJ

Ebu Dherri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Babi im është tepër i plakur dhe nuk mundet me udhëtua as për në Haxh as për në Umre.

Muhamedi a.s. iu është përgjegj: Kryeje haxhin ose urren për babën tënd.

Darëkutniju thotë se të gjithë transmetuesit e hadithit janë të besueshëm.

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Babi im ka vdekur dhe nuk e ka krye haxhin, ata kryej haxhin për të?

Muhamedi a.s. i ka thënë:

“Çka mendon po të kishte pasur babi yt borxh dhe ti ia kryen, a nuk të pranohet kryerja e borxhit, pra krye haxhin për të.”

E ka regjistrua Darëkutniju

Vet mënyra e pyetjes dhe përgjegjës tregon për pranimin dhe vlefshmërinë e haxhit e jo për atë se është obligim (vaxhib). Allahu i Lartmadhëruar e di më së miri.

MES-HI I MESTEVE

Është pyet i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për Mes-hin mbi meste ?

Është përgjigjur: Udhëtarit (mysafirrit) i vlen Mes-hi mbi meste tri ditë ndërsa jo udhëtarit vendasit një ditë dhe një natë.

Ebu Umare e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: O i Dërguari i Allahut a të jap mes-hi mbi meste?

Iu është përgjigj:

- Po.

- A vlen për një ditë?
- Po.
- A vlen për dy ditë?
- Po.
- A vlen për tri ditë?
- Po, vlen edhe për tri ditë, nëse ti dëshiron edhe më shumë .

E ka regjistrua Ebu Davudi

Një pjesë e dijetarëve e kanë kuptua hadithin nga aspekti i jashtëm sa që e kanë lejuar mes-hin për kohë të përcaktuar.

Një pjesë tjetër e dijetarëve mendojnë se ky Hadith është i papërcaktuar (mutlak) dhe hadithet tjera e kanë përcaktuar (mukajid) ndërsa rregull është se vepohet me hadithin e përcaktuar (mukajid).

CILI ËSHTË NAMAZI MË I VLEFSHMI?

E kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Cili namaz është namazi më vlefshmi?

Është përgjigj:

Namazi ku e ka lutjen më të gjatë dhe më të thellë të Kunitit.

E ka regjistrua Ahmedi

Po cili namaz i natës është më i vlefshmi ?

Është përgjigj: Namazi i mesit të natës edhe pse falet shkurt.

Po ashtu është pyetur: Cila orë është ora më e afërta tek Allahu nga orët tjera?

Është përgjigj: Po, është ora e thellësisë së natës, a po mesnatës.

E ka regjistrua Nesaiju

CILI AJET I KUR'ANIT ËSHTË MË MADHËSHTORI?

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Cili ajet i Kur'anit është më madhështori?

Është përgjigj: Ajetul Kursija.

Pra: Allahu La Ilahe Il-la Huvel Hajjul Kajjum

ÇKA I LEJOHET BURRIT ME VEPRUA ME GRUAN E TIJ DERI SA AJO TË JETË NË FAZËN E MENSTRUACIONIT

Ka ardhur një njeri te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i ka thënë: Çka më lejohet mua në gruan time deri sa ajo të jetë me menstruacion?

Iu është përgjigj: E vendos jetekun deri në pjesën e epërme e pastaj çka të duash vepro prej pjesës së mesme të trupit e më lartë.

E ka regjistrua Maliku

VEPRAT E MIRA TË PËRGJITHMONSHME

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për veprat e mira të përgjithmonshme.
Është përgjigj: Tekbiri

Tehlili

Tesbihi

Tahmidi dhe

Ve La Havle Ve La Kuvete Il-la Bil-lah